



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr.97  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302  
Prishtinë, më 10 qershor 2024, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Mirsad Shkreta, Bekim Haxhiu, Floretë Zejnullahu dhe Shemsedin Dreshaj, anëtarë.

**Munguan:** Haxhi Avdyli, Burim Meta dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

**Pjesëmarrës të ftuar :** Virtyte Krasniqi, kryesuese e Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, dhe Kadri Bytyçi, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës.

**Stafi mbështetës:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Kadrije Sherifi dhe Amir Keka, MSH.

**Mbledhjen e kryesoi** Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.05.2024;
3. Diskutim për Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30. 5. 2024**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 30.5.2024, u miratuan pa vërejtje.*

### **3. Diskutim për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale**

**Fatmire Kollçaku**, pas propozimit nga mbledhja e kaluar, që të ftohet në mbledhje, Komisioni për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, për të diskutuar lidhur me listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, ne kemi ftuar kryesuesen e këtij Komisioni, ku së bashku më të, janë të pranishëm edhe përfaqësuesit tjerë të Ministrisë së Shëndetësisë, por në ndërkohë jemi njoftuar nga MSH-ja, se vendimi i miratimit të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, pas disa ankesave të palëve aplikuese, është anuluar. Për të e sqaruar çështjen e anulimit të vendimit, më në detaje, fjalën po ia kaloj përfaqësues së MSH-së.

**Kadrije Sherifi, nga Ministria e Shëndetësisë**, sqaroi se vendimin e ministrit të Shëndetësisë për anulimin e listës zyrtare për çmimin e produkteve medicinale, e ka marrë më datë 6.6.2024, e cila listë ishte miratuar më datë 15.5.2024. Anulimi është bërë pas disa ankesave të palëve aplikuese. Kundër publikimit të listës zyrtare për çmimin e produkteve medicinale dhe vendimeve të lëshuara në procedurë të inspektimit, sipas këtij ligji, lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative. Palët aplikuese kanë parashtruar ankesa me pretendimet e tyre, disa prej të cilave janë të konfirmuara nga Komisioni i Ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë. Pas shqyrtimit të ankesave, Komisioni duhet që brenda një afati sa më të shkurtër kohor, të bëjë propozimin e ri për listën përfundimtare.

**Viryte Krasniqi, kryesuese e Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale**, tha se vendimi nuk është që të anulohet në tërësi lista zyrtare për çmimin e produkteve medicinale, por duhet sërish të rishikohet lista e çmimeve të barnave, pasi që kundër vendimit për listën ka pasur ankesa dhe disa prej pretendimeve janë konfirmuar nga Komisioni i Ankesave, që funksionin brenda MSH-së dhe ankesat kanë pasur të bëjnë me çmimet e disa produkteve. Ajo theksoi se derisa Komisioni për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, është funksionalizuar, në përbërje të komisionit janë bërë ndërrime të shumta, për shkak të orareve të ndryshme të mbledhjeve. Ky komision nuk paguhet, ka pasur problem pse anëtarët e komisionit nuk paguhen, sepse është punë shumë e rëndë dhe profesionale. Listat zyrtare nuk mund të jenë gjithmonë publike. Duhet ditur çmimet se a janë me TVSH, apo pa TVSH, nuk mundemi veç thjesht të vendosim çmime. Ajo tha se ligji është në zbatim e tutje dhe komisioni i ka verifikuar çmimet, që janë të deklaruara me mirëbesim. Kjo listë është dinamike. Çdo listë duhet të rigjenerohet çdo muaj dhe rishqyrtim kemi pasur gjatë gjithë kohës. Nuk kam bazë ligjore për t'iu referuar produkteve në treg, vetëm importit.

**Bekim Haxhiu**, tha se pas publikimit të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, e kemi analizuar listën e çmimeve dhe jemi zhgënjyer, sepse ngritja e çmimeve na del rritje 50%, 100%, dhe 300%, për disa produkte nga kjo listë zyrtare. Ideja e miratimit të Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, ka qenë se përmes këtij ligji të këtë unifikim dhe zbritje të çmimeve. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, duhet të njoftojë për marzhën e fitimit në tregtinë me pakicë dhe shumicë. Nëse shkoni në barnatore nuk ka aspirinë me 2 euro, andaj përmes këtij ligji është dashur të zbriten çmimet, si p.sh. për aspirinë, vetëm janë rritur çmimet, pastaj rreth

40% të barnave kanë mbetur jashtë kësaj liste. Sa i përket përbërjes së Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, në kohën kur është shqyrtuar Projektligji për çmimin e produkteve medicinale, qysh atëherë është propozuar amendament që ky komision të propozohet nga ministri i Shëndetësisë, pastaj të dërgohet për votim në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, për t'iu shmangur konfliktit të interesit dhe përbërja e këtij Komisioni të jetë mikse prej disa institucioneve, që kanë për obligim zbatimin e këtij ligji, ndërsa tash me ligjin që është në fuqi, ministri me vendim emëron anëtarët e Komisionit për çmime të produkteve medicinale prej 7 (shtatë) anëtarëve. Pastaj, Komisioni i Ankesave është themeluar me vendim të ministrit. Këtë që vetë e ka miratuar dhe anuluar, atëherë këtu kemi të bëjmë me konflikt interesi. Në vijim, pyeti: Në Komisionin për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, a ka qenë i ftuar përfaqësuesi nga Oda e Farmacistëve të Kosovës?

**Armend Zemaj**, tha se për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, është dashur të jetë prezentë në këtë mbledhje ministri i Shëndetësisë, z. Arben Vitia, pasi që ai është nënshkruer i vendimit, dhe kërkoi që për këtë çështje, në mbledhjen e radhës së komisionit, të ftohet ministri i MSH-së, pasi që ai është nënshkruer i vendimit dhe janë këto elemente që tregojnë paaftësinë, neglizhencën, edhe pas një viti të hyrjes në fuqi të këtij ligji, i cili para tri javëve hyri në fuqi me vendim të këtij ministri e që javën e shkuar u anulua me vendim nga ky ministri, andaj kjo çështje nuk duhet të kalojë në heshtje, duhet të merret përgjegjësi nga personat përgjegjës. Pyeti: Kush ka qenë në Komisionin e Ankesave dhe cili është raporti i tyre me MSH-në? Cilat janë arsyetimet konkrete, pse është anuluar vendimi i miratimit të listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale?

**Fatmire Kollçaku**, tha se sa i përket ftesës, së është dashur të ftohet ministri i Shëndetësisë, z. Arben Vitia. Po ashtu, sqaroi se propozimi ka qenë që të ftohet veç Komisioni për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale. Ajo tha se është mirë që është marrë vendimi, që sërish të rishikohet lista e çmimeve të barnave, duke i marrë parasysh vërejtjet e palëve.

**Shemsedin Dreshaj**, tha se gjatë hartimit të Projektligjit për çmimin e produkteve medicinale, ka pasur mangësi dhe tash zbatimi e këtij ligji në praktikë po na paraqet vështirësi. Gjatë fazës së amendamentimit në Komision, ka pasur hezitime për këtë ligj, se si të rregullohen çmimet përfundimtarë tavan dhe është shoqëruar me debate të shumta brenda grupit punues të Komisionit dhe asnjëherë nuk e kemi pasur të qartë nga Ministra e Shëndetësisë, që është hartuesit i këtij ligji, se si do ta zbatojnë në terren, prandaj ligji është aprovuar që të këto rregulla unike të caktimit të çmimeve për produkte medicinale. Në vijim, pyeti: Në përbërje të Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, u tha nga kryesuesja e këtij Komisioni, se janë bërë ndërrime të shumta, a keni pasur presion politik? A është e vërtetë që prej 7 (shtatë) anëtarëve që janë në përbërjen e këtij komisioni, keni mbetur vetëm 3 (dy)? Dhe, a është e vërtetë që për ta funksionalizuar përbërjen e komisionit prej 7 (shtatë) anëtarëve, është dashur të shfuqizohen udhëzime administrative dhe rregullore, pasi që disa prej këtyre anëtarëve të emëruar nga ministri i MSH-së, kanë pasur konflikt të interesit?

**Virtyte Krasniqi, kryesuese e Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale**, iu përgjigj pyetjes: për ndërrimet në përbërje të Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, tha se ka pasur ndërrime për shkak të konfliktit të interesit që kanë pasur anëtarët e

emëruar. Lidhur me listën e çmimeve për produkte medicinale, tha se është dashur të merren konfirmimet zyrtare prej shteteve që importojmë, për ta ditur se çfarë çmimi duhet vendos. Sa i përket rritjes së disa çmimeve të barnave te lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale, ato rritje kanë qenë për shkak të disa lëshimeve teknike, por më shqetësuese për ne është se disa kompani farmaceutike nuk e kanë deklaruar çmimin, andaj do të këtë rishikim dhe kjo listë do të ndryshojë për çdo muaj, pasi që kjo listë është vetëm preliminare. Sa i përket raportit që kanë me Komisionin e Ankesave, tha se i kanë raportet kolegjiale, kemi pasur mendime të ndryshme, por vendimet tona janë sipas ligjeve.

**Bekim Haxhiu**, tha se lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale, në bazë të Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, është për një vit, por për ndryshime të caktuara të produkteve, kjo listë përditësohet, andaj për të e sqaruar këtë çështje, i ftuar ka qenë edhe kryeshef ekzekutiv nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që ka deklaruar se është meritë për këtë listë, por që nuk ka ardhur. Kur kam bërë kërkesën në AKPPM, që të ma dërgojnë listën e barnave esenciale për vitet 2021-2022, pastaj edhe është anuluar vendimi për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale.

**Kadri Bytyçi, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës**, tha se fillimisht kanë qenë të në përbërjen e Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, me një anëtar nga Oda e Farmacistëve, pastaj ky anëtar është shkarkuar nga ky komision, duke mos na dhënë ndonjë arsytim, pse është përjashtuar dhe nuk kemi pasur asnjë njoftim nga kryesuesja e Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, se pse është shkarkuar anëtari nga Oda e Farmacistëve të Kosovës.

**Viryte Krasniqi, kryesuese e Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale**, tha se arsyeja e shkarkimit është bërë për shkak se anëtari në fjalë ka qenë destruktiv, ka kërkuar vazhdimisht që kjo listë të shtyhet me secilin anëtar, ka pasur konflikt. Pra, ka ardhur dhe ka mbajtur takime, ka lëshuar fjalë, por asnjëherë nuk ka bërë ankesë për mostransparencë. Nuk ka pasur fshehje, të gjithë kanë pasur dilema, se ai ka pasur qëllim vetëm prolongimin e procesit, nuk e dimë se ka pasur interes për të mbrojtur Odën Farmacistëve të Kosovës apo kompanitë e farmacistëve.

**Kadri Bytyçi, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës**, së pari është dashur me qenë të informuar, ne përfaqësuesit e OFK-së, se anartri i deleguar paska ka qenë destruktiv, jo bashkëpunues dhe për këtë çështje duhet të vërtetohen faktet.

**Viryte Krasniqi, kryesuese e Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale**, sqaroi se përfaqësuesin e Odës së Farmacistëve të Kosovës, ashtu siç e emëron ministri i MSH-së, ka të drejtë ta shkarkojë. Ajo çka kam kërkuar prej ministrit, është për ta zëvendësuar me një anëtar tjetër.

**Mirsad Shkreta**, tha se gjatë zbatimit të Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, kemi pritur që do të hasim në probleme, pasi që për herë të parë në vendin tonë po krijojnë një sistem rregullator për çmimin e barnave. Në grupin punues të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe

Mirëqenie Sociale, kemi bërë fuzionomini e propozimeve që të këtë unifikim të çmimeve të produkteve medicinale. Ju si Komisioni për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, duhet të jeni më transparent në këtë drejtim, që ta publikoni rregulloren e punës, në mënyrë që gupet e interesit të stopohen me këtë ligj, do ta keni mbështetjen tonë për të ecur në këtë proces.

**Floretë Zejnullahu**, tha se është një vit prej se është miratuar Ligji për çmimin e produkteve medicinale, ende nuk ka filluar të zbatohet asnjë dispozitë prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, andaj çdo vonësë shkon në dëm të pacienteve, qytetarëve dhe nuk ju intereson konflikti i interesit që paska pasur përbërja anëtarëve të Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, të emëruar nga ministri i Shëndetësisë. Ajo tha se te neni 3, që është kosto e përballueshme të produkteve medicinale të nevojshme dhe efikase për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës, me listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, që e keni pasur të miratuar, nuk ka pasur kosto të përballueshme. Kërkoj që të na dërgoni listën e plotë të anëtarëve të Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, po ashtu kërkoj që përfaqësuesi nga Oda e Farmacistëve të Kosovës, të jetë në çdo kohë në përbërje të këtij komisioni, sepse i takon përfaqësimi.

**Labinotë Demi-Murtezi**, tha se gjatë kohës kur e kemi shqyrtuar Projektligjin për çmimin e produkteve medicinale, qysh atëherë, i kam ngritur dilemat dhe kam kërkuar sqarim prej përfaqësuesve të MSH-së, rreth përbërjes së anëtarëve të Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, se mund kenë konflikt të interesit, përderisa nuk është cekur në ligj se nga cilat institucione do të emërohen këta anëtarë të këtij komisioni, sepse tash pas një viti të hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë dalë këto probleme. Ajo tha se nëse 40% për qind e produkteve medicinale, nuk janë përfshirë në listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, atëherë kjo çështje është shqetësuese. E kaptojmë se ky ligj është kompleks në zbatim, por ju në grupin punues duhet të jeni më të kujdesshëm, në vendosjen e listës përfundimtare, në mënyrë që të zbatohet në tërësi ligji.

**Armend Zemaj**, propozoi që në e mbledhjen e radhës për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, të ftohet ministri i Shëndetësisë, z. Arben Vitia, sepse ai e ka emëruar përbërjen e anëtarëve të këtij komisioni, ndërsa me këta s' kemi çka të diskutojmë, vetëm në aspektin profesional. Ne si politikbërës, na intereson përgjegjësia e vendimmarrjes. Kërkoj që të na dërgohen me shkrim listat e vendimeve prej fillimit dhe ato vendime, të cilat janë ndryshuar gjatë procesit.

**Shemsedin Dreshaj**, tha se pajtohet që të ftohet ministri i Shëndetësisë dhe kryeshef ekzekutiv nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, pasi që i bëra tri pyetje, për dy nuk mora përgjigje.

**Bekim Haxhiu**, propozoi që mbledhja e radhës të mbahet të martën e ardhshme, më datën 18 qershor 2024, pos ministrit të Shëndetësisë, të ftohet edhe kryeshef ekzekutiv i AKPPM-së.

**Fatmire Kollçaku**, tha edhe pse vendimi për listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale, është pezulluar dhe për një kohë, siç po e sqarojnë përfaqësuesit e MSH-së, në mënyrë që të rishikohet edhe njëherë lista e çmimeve të barnave. Propozimi është që të ftohet ministri i Shëndetësisë dhe kryeshef ekzekutiv i AKPPM-së dhe pajtohemi për këtë gjë, edhe pse ky vendim është anuluar, në këtë kohë që po diskutojmë.

#### **4. Të ndryshme**

*Për pikën të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Fatmire Kollçaku,**

**Kryetare e Komisionit**

---